

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Sunlight Escape Villas" sh.p.k

Sot më datë, 12.04.2024 ne shtetasit :

1. **Z.Florjan Shima, atësia Hasan**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes, 27.03.1985 i identifikuar nga dokumenti i identifikimit tip leternjoftim me nr.personal **I50327077J**, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Shoqëria e huaj "DM & AM HOLDINGS LIMITED"** e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar me nr.13024445, perfaqesuar nga ortakut dhe njëkohesisht administrator i shoqërisë **Z.Elton Metalla**, shtetas Britanik, lindur ne Mullet, Shqiperi me datë 12.01.1981, i identifikuar me anë të pasaportes së Mbreterise se Bashkuar me nr.575458793, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilesinë e "ortakeve themelues" kemi redaktuar këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lire të plote, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 date 14.04.2008, " Për shoqërite tregtare ", në ligjin " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, vendos të krijojme shoqërinë tregtare, me pergjegjësi të kufizuar "**Sunlight Escape Villas**" sh.p.k .

Neni 1 Krijimi

Shoqëria "**Sunlight Escape Villas**" sh.p.k është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (këtu e më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.


Shoqëria "**Sunlight Escape Villas**" sh.p.k është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia

Shoqëria e ka selinë në Adresën:

- Rruga "George W Bush", Kulla 1, Apartamenti nr. 34, Perballe parlamentit, Njesia nr.2, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4 **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Biznesit .

Neni 5 **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

“Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe investimeve ne ndertim. Projektim plane rregullues qendra banimi, studime urbanistike, ndertime civile, ekonomike, industriale etj. Per drejtim punimesh (supervizion e kolaudim). Ndertime rrugore, ndertime hidroteknike, rikonstruksione godinash civile. Ndertimin e rrjeteve inxhinierike. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma dhe ndermarrije te tjera te cilat mund te kene dhe qellime te tjera aktiviteti. Tregtim, import-eksport te materialeve te ndryshme ndertimore. Shit-blerje e pasurive te paluajtshme, dhenie me qira. Gjithashtu per te realizuar objektin dhe qellimet e saj shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje çdo lloj aktiviteti qe ka lidhje me objektin e veprimtarise se kesaj shoqerie dhe çdo veprimtari ne lidhje me te dhe çdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise dhe qe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar”.

Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 30.000.000 (tridhjetë milion) Leke dhe është i ndarë në 2 kuota , vlera nominale e te cilave eshte:

- **Florjan Shima** 1(nje) kuotë me vlerë nominale 12.000.000 (dymbëdhjetë milion lekë, pra eshte zoterues i 40 % të kuotes se kapitalit.
- **Shoqeria “DM & AM HOLDINGS LIMITED”** 1(nje) kuotë me vlerë nominale 18.000.000 (tetëmbëdhjetë milion) lekë, pra është zoterues i 60 % te kuotes se kapitalit të zotëruara nga ortakët e shoqërisë, kuota këto me vlerë të përgjithshme 30.000.000 (tridhjetë milion) Leke të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.


Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqërisqë përkundërt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët, Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nëpërmjet prokurës.



2 | F a q e

Administratori – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8
Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e Ortakeve .
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 9
Administrimi

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë. Asambleja e Ortakeve vendos për sistemin e administrimit, dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcakton numrin e tyre dhe kompetencat. Administratori/rët, mund të jenë ose jo ortakë. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.
Administrator i shoqërisë është Z.Florjan Hasan Shima, për një periudhe 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 10

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare".
Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi pasi u redaktua dhe lexua nga ortakët themelues, miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare , nënshkruhet prej tyre.

ORTAKËT THEMELUES

SHOQERIA "DM & AM HOLDINGS LIMITED"

PERFAQESUAR NGA

ELTON METALLA



FLORJAN SHIMA

FLORJAN SHIMA
